



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA E PRESIDENTIT - URED PREDSEDNIKA - OFFICE OF THE PRESIDENT
KABINETI - KABINET - CABINET

MARRËVESHJE

ndërmjet

Nr. Prot.:	1030	Niv. Org.:	C-01
Pr. No.:		Org. Udh.:	
Nr. i fletëve:	10	Data:	21, 08, 2012
Str. shtetërore:		Date:	
No. pages:			

PRISHTINËJA

QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

dhe

QEVERISË SË MBRETËRISË SË SUEDISË

**për bashkëpunim në zbatimin e ligjit për parandalimin dhe
luftimin e krimeve të rënda**

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Mbretërisë së Suedisë më tutje të referuara si "Palët",

Duke konsideruar të rëndësishëm forcimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit për zbatimin e ligjit në luftimin e krimit,

Duke pasur parasysh se një bashkëpunim i tillë duhet të bëhet në mënyrë sa më efektive që është e mundur, duke marrë parasysh kërkesat e sigurisë juridike,

Duke qenë të udhëhequr nga parimet e respektit të ndërsjellë për sovranitetin, barazinë, reciprocitetin dhe përfundimin e ndërsjellë, si dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit,

Duke vënë në dukje me shqetësim lidhjet në mes të terrorizmit ndërkombëtar dhe krimit të organizuar transnacional,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Palët do të bashkëpunojnë, në përputhje me legjislacionin përkatës kombëtar në luftimin e krimit, ku parandalimi, zbulimi, hetimi dhe ndjekja penale kërkon masa të përbashkëta nga autoritetet kompetente të të dyja Palëve, sikurse, trafikimi i paligjshëm i drogave narkotike, substancave psikotrope, trafikimi i qenieve njerëzore, krimi kibernetikë, pastrimi i parave, aktet e terrorizmit, duke përfshirë financimin e terrorizmit dhe krimeve të tjera të organizuara dhe të rënda.
2. Palët përmes kanalëve diplomatike, njoftojnë autoritetet kompetente të njëra tjetrës për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

1. Format e bashkëpunimit në mes të Palëve do të përfshijnë shkëmbimin e informacionit, gjetjen dhe identifikimin e personave dhe masa të tjera të cilat janë në pajtim me objektivat e kësaj Marrëveshjeje dhe me atë se çka Palët kanë marrë përsipër sipas marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare dhe në kuadër të legjislacionit përkatës kombëtar.

2. Autoritetet kompetente të Palëve përveç kësaj mund të bashkëpunojnë nëpërmjet shkëmbimit të përvojës dhe specialistëve, si dhe duke pajisur njëra tjetrën me informacione të tjera ligjore, informacione për punën e zbatimit të ligjit, çështjeve organizative, etikës profesionale dhe informacioneve në lidhje me gjendjen e krimit dhe trendët e krimit në shtetet e tyre.
3. Kjo Marrëveshje nuk do të ndikoj në çështjet lidhur me ofrimin e ndihmës së ndërsjellë juridike në çështjet penale, bashkëpunimit gjyqësor ose të ekstradimit, të cilat do t'i nënshtrohen marrëveshjeve të ndara ose akordimit në mes të Palëve.

Neni 3

1. Kërkesat për informacion ose masat tjera në përputhje me këtë Marrëveshje do të bëhen me shkrim nga autoritetet kompetente të komunikuar në përputhje me nenin 1, paragrafin 2 të kësaj Marrëveshje. Kërkesat e tilla do të bëhen direkt në mes të autoriteteve kompetente dhe do të kthehen përmes kanaleve të njëjta. Kur kërkohet, për shkaqe urgjente, mund të pranohen kërkesat gojore, por duhet të konfirmohen me shkrim sa më shpejt që të jetë e mundur.
2. Dokumentet e nevojshme për ekzekutimin e kërkesave të tilla do ta shoqërojnë kërkesën. Kërkesat e tilla dhe dokumentet shoqëruese do të jenë në gjuhën e Palës që i kërkohet ose në gjuhën angleze pa vërtetim të kërkuar.
3. Nëse një kërkesë nuk i përmbushë kërkesat formale sipas legjislacionit kombëtar të secilit vend, mund të kërkohet korrigjimi ose plotësimi i saj.
4. Nëse autoriteti pranues nuk është kompetent për përmbushjen e kërkesës, autoriteti duhet pa vonesë ta përcjellë kërkesën tek autoriteti kompetent i Palës që i është kërkuar dhe të informojë autoritetin e Palës kërkuese në përputhje me rrethanat.

5. Zakonisht, Palët do të heqin dorë nga pretendimet për rimbursimet e shpenzimeve të bëra për zbatimin e kësaj Marrëveshje, me përjashtim të shpenzimeve për tarifata e paguara për ekspertët. Nëse shpenzimet e një natyre thelbësore dhe të jashtëzakonshme janë kërkuar ose do të kërkohen për të ekzekutuar një kërkesë, Palët do të konsultohen me njëra tjetrën për të përcaktuar kushtet sipas së cilave do të ekzekutohet kërkesa, si dhe mënyrën e mbulimit të shpenzimeve.

Neni 4

Kërkesa për bashkëpunim sipas nenit 3 paragrafit 1 mund të mohohet në qoftë se Pala që i kërkohet konsideron se një kërkesë e tillë mund të dëmtojë sovranitetin apo sigurinë e shtetit të saj ose se ajo bie në kundërshtim me parimet e përgjithshme juridike apo me interesa të tjera thelbësore të shtetit të saj. Në raste të tilla, Pala kërkuuese do të informohet pa vonesë të arsyeshme nga Pala që i është kërkuar për refuzimin dhe arsyet për refuzim.

Neni 5

1. Informacionet dhe dokumentet të cilat janë pranuar brenda kornizës së kësaj Marrëveshje, nuk do të përdoren për qëllime të tjera nga ato të përcaktuara në kërkesë dhe të pranuar nga Pala që i është kërkuar pa pëlqimin me shkrim të Palës që i është kërkuar.
2. Palët në mënyrë vullnetare apo sipas kërkesës, do ta informojnë njëra tjetrën për rezultatin e përdorimit të informacionit të pranuar.
3. Në rast të dhënave të pasakta apo të pakompletuara, Palët pa vonesë do ta njoftojnë njëra tjetrën.

Neni 6

1. Informacioni që është pranuar nga njëra Palë, do të mbahet në besueshmëri në pajtim me legjislacionin kombëtar, nëse zbulimi i informacionit do të

çrregullonte marrëdhëniet ndërmjet palëve ose përndryshe do të dëmtonte cilëndo palë.

2. Palët do të sigurojnë mbrojtjen e informacionit të pranuar, sipas kësaj Marrëveshje kundrejt qasjes, ndryshimit, publikimit ose shpërndarjes së paautorizuar, në pajtim me legjislacioni përkatës kombëtar.

Neni 7


1. Shkëmbimi i të dhënave personale, në pajtim me këtë Marrëveshje, do t'i nënshtrohet legjislacionit kombëtar të Palëve. Secila Palë ka të drejtë të refuzojë një kërkesë në qoftë se niveli i mbrojtjes së të dhënave konsiderohet të jetë joadekuat. Traktatet ekzistuese ndërkombëtare për mbrojtjen e të dhënave duhet të përdoren si udhëzues për vlerësimin e nivelit të mbrojtjes së të dhënave të ofruara nga Pala kërkuese.
2. Kur vlerësohet niveli adekuat i mbrojtjes së të dhënave personale të ofruara nga Pala kërkuese, Mbretëria e Suedisë do të aplikojë parimet e mbrojtjes së të dhënave në përputhje me Konventën e Këshillit të Evropës e vitit 1981 për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me përpunimin automatik të dhënave personale.
3. Kur vlerësohet niveli adekuat i mbrojtjes së të dhënave personale të ofruara nga Pala kërkuese, Republika e Kosovës do të aplikojë mbrojtjen e të dhënave në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (2010) Nr. 03/L-172.

Neni 8

1. Një Komision i Përbashkët i përbërë nga përfaqësuesit e autoriteteve relevante qeveritare të Palëve, do të:
 - a) shqyrtojnë zbatimin e kësaj Marrëveshje;

2. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar. Secila Palë mund ta shkëputë këtë marrëveshje me anë të njoftimit me shkrim bërë Palës tjetër. Shkëputja do të ketë efekt gjashtë (6) muaj pas datës së marrjes së njoftimit.
3. Edhe nëse Marrëveshja është shkëputur, dispozitat e nenit 5 dhe 6 do të respektohen .

Nënshkruar në *Prishtinë*, më *18. Qershor* 2012, në dy kopje origjinale, secila e shkruar në gjuhët zyrtare të Palëve (shqipe, serbe dhe suedeze) si dhe në gjuhën angleze ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast të ndonjë mosmarrëveshje do të mbizotëroj teksti në gjuhën angleze.


PËR
QEVERINË E REPUBLIKËS
SË KOSOVËS


PËR
QEVERINË E MBRETËRISË
SË SUEDISË



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PRESEDNIK

**DEKRET PËR RATIFIKIM TË MARRËVESHJES
NDËRKOMBËTARE**

Duke u bazuar në nenin 18, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në nenin 10 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-052, për Marrëveshjet Ndërkombëtare si dhe në nenin 4, pika 3 të Ligjit Nr. 03/L-004 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik:

D e k r e t o j

Ratifikimin e Marrëveshjes Për bashkëpunim në zbatim të ligjit për parandalimin dhe luftimin e krimeve të rënda, në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Suedisë, e nënshkruar në Prishtinë më 18 qershor 2012, dhe të pranuar në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës me datë 21 gusht 2012.

Marrëveshja e ratifikuar i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim, në përputhje me nenin 18, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Marrëveshja e ratifikuar hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare.

Nr. i Dekretit: DMN-008-2012

Prishtinë, më 23 gusht 2012



Atifete Jahjaga
Presidente e Republikës së Kosovës